



URRA!

REVISTA MBI
BARAZINË GJINORE DHE
KUNDËR LLOJEVE TË
DISKRIMINIMIT.

Të dashur/a Mësues/e dhe Prindër,
përmes kësaj reviste proaktive përpiqemi t'u
flasim Vogëlusheve dhe Vogëlushëve për një
marrëdhënie të barabartë mes tyre, megjithë
dallimin, të ndërsjellë e të besueshme.

Dhe janë pikërisht këto tema në të cilat e kemi
bazuar iniciativën tonë, me objektivin që
barazia gjinore dhe mbrojtja e pakicave ndaj
llojeve të diskriminimit të mund të rrëfehët me
lehtësi dhe entuziazëm nëpërmjet mjetit
mësimor më efikas: loja.

Pra, urojmë që kjo përmbledhje të mund të
kontribuojë proaktivisht, me ndihmën Tuaj të
vyer, për të parandaluar dhe luftuar shfaqje të
racizmit si dhe për të plotësuar një nevojë
gjithnjë e më të përhapur dhe të nevojshme në
mbushjen e boshllëqeve dhe heshtjeve mbi
argumentet e trajtuara.

KJO PËRMBLEDHJE I PËRKET:

EMRI

SHKOLLA

KLASA

PËRSHËNDETJE, NE DO TË TË SHOQËROJMË NË ZBULIMIN
E KËSAJ PËRMBLEDHJEJE TË MREKULLUESHME.
PRANDAJ, SI FILLIM, LE TË PREZANTOHEMI:

RAVI

CINZIA

DANIELE



MIRIANA

BALI

SHAILA

KËSHILLË

NËSE GJATË LEXIMIT TË KËSAJ REVISTE DO TË HASËSH FJALË
OSE FJALI QË NUK JANË TË QARTA PËR TY, SHKO NË FAQEN 18 I
SHOQËRUAR NGA NJË I RRI TUR DHE MUND OHLI TË KËRKOSH
SHPJEGIMIN E TYRE TEK "FAQJA E QARTËSISË".





"NA NDIHMO TË GJEJMË
NJËRI-TJETRIN!"



LABIRINT

MERR PJESË EDHE TI NË GARËN PËR NJË BOTË MË TË
MIRË. FITO EDHE TI MEDALJEN E ARTË TË BARAZISË,
KUNDËR SJELLJEVE TË PAHIJSHME, LLOJEVE TË
DISKRIMINIMIT DHE RACIZMIT!




RROFSHIN !LOJRAT NË GRUP!

MUND TË TË DUKET E ÇUDITSHME, POR NUK EKZISTOJNË LOJRA "VETËM PËR DJEM", "VETËM PËR VAJZA", "VETËM PËR ITALIANË", "VETËM PËR SHQIPTARË" APO ... "VETËM PËR INDIANË". KËTO JANË NNDARJE TË KOTA.

NE TË GJITHË
MUND TË LUAJMË
SI TË DUAM E SI
TË NA PELQEJË:

TË GJITHË
BASHKË!



NGJYROS
ILLUSTRIMIN DHE
PERSONAZHET QË E
PËRBËJNË

PËR TEMËN E BARAZISË GJINORE MES BURRIT DHE GRUAS... LEXO PYETJET E MËPOSHTME DHE VENDOS NJË SHENJË X ATY KU MENDON SE ËSHTË PËRGJIGJJA E SAKTË. PASTAJ KTHE FAQEN DHE KONTROLLO REZULTATET.

**KUSH I
LAN ENËT?**

- A** BURRË
B GRUA
C TË DY

**KUSH PUNON
NË ZYRË?**

- A** BURRË
B GRUA
C TË DY

**KUSH BËN
PAZARIN?**

- A** BURRË
B GRUA
C TË DY

ATËHERË, SIÇ MUND T'A KESH KUPTUAR DUKE PARË KËTO FIGURA PËRGJIGJET E SAKTA JANË ATO QË U PËRKASIN SHKRONJAVE "C". MES MESHKUVJE DHE FEMRAVE KA DISA DALLIME NATYRORE DHE BIOLOGJIKE, NDËRSA MES BURRIT DHE GRUAS NUK KA NDONJË DALLIM!

PRA, ËSHTË NORMALE PËR NJË BABA QË TË MERRET ME PUNËT E SHTËPISË DHE PËR NJË NËNË QË TË PUNOJË NË ZYRË. JETA ËSHTË NJË LOJË E MADHE NË GRUP KU TË GJITHË BËJNË GJITHÇKA, PA DALLIME.



KËRKO FJALINË

GJEJ DHE FSHI NË TABELË TË GJITHA FJALËT E RENDITURA MË POSHTË. NË FUND, SHKRONJAT E MBETURA DO TË FORMOJNË NJË FJALI. **JETË, DASHURI, RESPEKT, BARAZI, GRUP, EDUKATË, BULLIZIM.**

G R U P 🐶 E S H T Ë
B 🐱 U K U R 🐶 J E
T Ë B A R A Z I T
Ë 🐶 R R I H E T 🐱 E
D U K A T Ë 🐶 I T
R E S P E K T B 🐱
D A S H U R I B U L L
I Z I M 🐶 A S H K Ë

PËRSGJIDA E SAKTË: ËSHTË BUKUR TË PRINET BASHKË.

TREGO PËR VETEN!

PËRGJIGJU PYETJEVE NË VIJIM:

NË KLASËN TËNDE... A KA VOGËLUSHE DHE VOGËLUSHË ME KOMBËSI ITALIANE, SHQIPTARE DHE INDIANE?

A SHKONI MIRË ME NJËRI-TJETRIN, LUANI BASHKË?

PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË KIHET RESPEKT PËR TË TJERËT?

LIGJI ËSHTË I BARABARTË PËR TË GJITHË... DHE PËR TË GJITHA!

NË NATYRË TË GJITHË BURRAT DHE TË GJITHA GRATË JANË MË TË NGJASHËM
MES TYRE SESA GJITHÇKA TJETËR: SE MALET, SE DIELLI, SE HËNA, SE
ELEFANTËT BILES EDHE SE BIMËT E BORZILOKUT!

VLERA, SJELLJE, NDJESHMËRI, AFTËSI DHE KOMPETENCA JANË PASURI
KOLEKTIVE QË NE, TË GJITHË E TË GJITHA, I KEMI NË MASË TË BARABARTË.

EDHE REPUBLIKA ITALIANE E THEKSON KËTË BARAZI NË KUSHTETUTËN E SAJ.
ARGËTOHU DUKE PLOTËSUAR FJALËT ME RROKJET QË MUNGONJNË.

NENI 3

TË GJITHË SHTE..SIT GËZOJNË
DINJITET TË BARABARTË SHOQËROR
DHE JANË TË BARABARTË PARA
LIGJIT, PA ..LLIM GJINIE, RACE,
GJUHE, FE..., BINDJE POLITIKE,
GJENDJESH PERSONALE DHE
SHOQËRORE.

NENI 6

REPUBLI.. MBRON ME RREGULLORE
TË POSAÇME PA..CAT GJUHËSORE.

NENI 19

KUSHDO KA TE "DREJ..". TË
SHPREHË LIRISHT BESIMIN E
VET FE...

NENI 34

ARSI.. ËSHTË I HAPUR PËR
TË GJITHË.

NENI 37

PUNONJËSIT E GJINISË
FEMËRORE GËZOJNË TË
NJËJ... TË DREJTA DHE, PËR
TË NJËJTËN PUNË, PAGUHEN
NJËLLOJ ME PUNONJËSIT E
GJINISË MASHKULLORE.

NENI 48

KONSIDEROHEN ZGJEDHËS
TË GJITHË SHTETASIT, BU...
DHE GRA, TË CILËT KANË
MBU... MOSHËN MADHORE.

NENI 51

TË GJITHË SHTETASIT E
NJËRËS APO TJETRËS
GJINI MUND TË
USHTROJNË FUNKSIONE
PUBLI.. DHE TË ZGJIDHEN
POLITIKISHT NË KUSH...
BARAZIE, SIPAS KRITEREVE
TË PËR..KTUARA ME LIGJ.
PËR KËTË ARSYE REPUBLIKA
PROMOVON ME VEN..ME TË
POSAÇME MUNDËSITË E
BARABARTA MES GRAVE
DHE BURRAVE.

**"LAJMET E
FUNDIT!
EKSKLUZIVE:
MINISTRI ËSHTË
SHTATZËNË!"**



GJUHË DHE PUSHTET

**PO SI MUND TË JETË SHTATZËNË NJË MINISTËR?
E THJESHTË. ËSHTË GRUA. PO PËRSE, ATËHERË, NUK E QUAJMË "MINISTRE"?**

BARAZIA MES BURRIT DHE GRUAS MBASE DUHET TË GUEJË HAPËSIRË EDHE NË GJUHËN ITALIANE NË MËNYRË QË PËRDORIMI I PASAKTË I NJË SËRË FJALËSH TË MOS PËRBËJË PENGESË DHE CËNIM TË ROLIT TË GRUAS NË FAMILJE, POR EDHE NË SHOQËRI. PËR MË TEPËR, NË GRAMATIKËN E GJUHËS ITALIANE EKZISTON SI FORMA MASHKULLORE ASHTU EDHE AJO FEMËRORE, NDAJ LE T'I PËRDORIM TË DYJA.

SIDOMOS KUR FLITET PËR DISA FUNKSIONE DHE DISA PROFESIONE, TË PERCEPTUARA PËRHERË SI PRIVILEGJ I BURRAVE.

USHTRIMI

A DO T'A QUAJE NDONJËHERË "SHTËPIAKJA", APO "MËSUESJA", NJË BURRË? JO, BESOJ? ATËHERË, PËRSE THUA "AVOKATI" EDHE NËSE I REFEROHESH NJË GRUAJE?

KTHE NË GJININË FEMËRORE PROFESIONET E MËPOSHTME:

ARBITËR >

ARKITEKT >

DREJTUES >

KIRURG >

KOMISAR >

KËSHILLTAR >

DEPUTET >

INXHINIER >

INSPEKTOR >

NOTER >

PREFEKT >

DREJTOR VENDOR I POLICISË >

SENATOR >

KRYETAR BASHKIE >

NËSE KE MËDYSHJE, PËRSGJIGJET E SAKTA DO T'I GJESH NË FAQEN 18.



FJALIA E KODUAR




I Z M J O



A R C T

CAKTOJI SECILIT SIMBOL SHKRONJËN PËRKATËSE



ZËRIDHJA: JO PËCIZMIT

EPITETET

MES KËTYRE FJALËVE ZGJIDH MË TË PËRSHTATSHMET PËR TË PËRSHKRUAR SECILIN NEGA ANËTARËT E KËSAJ FAMILJE:

*FORCË, HIR, AUTORITET, BUTËSI,
URTËSI, BUKURI, SHPEJTËSI,
GUXIM, MIRËSI, DURIM*

VOGËLUSHE

VOGËLUSH

NËNË

BABA





ËSHTË PJESE E BASHKIMIT EVROPIAN.

NË NENIN 2 TË TRAKTATIT QË E BASHKON ATË ME SHTETET E TJERA THUHET KËSHTU:

"BASHKIMI KA NË THEMEL VLERAT E RESPEKTIMIT TË DINJITETIT NJERËZOR, TË LIRISË, TË DEMOKRACISË, TË BARAZISË, TË SHTETIT TË SË DREJTËS DHE TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIT, DUKE PËRFSHIRË TË DREJTAT E PERSONAVE QË U PËRKASIN PAKICAVE. KËTO VLERA JANË TË PËRBASHKËTA PËR SHTETET ANËTARE NË NJË SHOQËRI TË KARAKTERIZUAR NGA PLURALIZMI, NGA MOSDISKRIMINIMI, NGA TOLERANCA, NGA DREJTËSIA, NGA SOLIDARITETI DHE NGA BARAZIA MIDIS GRAVE DHE BURRAVE".

RISHKRUAJE NENIN PËR T'A MBAJTUR MEND MË MIRË...

JEP VOTËN TËNDE!

A PO

B JO

C NUK E DI

JE DAKORT ME NE?

VENDOS NJË SHENJË X TEK PËRGJIGJA JOTE DHE MË PAS KRAHASOJE ATË ME PËRGJIGJET E SHOQEVE DHE SHOKËVE TË KLASËS TËNDE.





PO ÇFARË
RËNDËSIE KA
NGJYRA E
LËKURËS...



PO KUJT I
INTERESON NËSE
GJUHA JOTE ËSHTË
E NDRYSHME NGA E
IMJA...



AJO QË MË
INTERESON
MË TEPER
ËSHTË TË DI
QË MUND TË
MBËSHTETEM
TEK TY!



NJE DITË BOTA
DO TË JETË E
JONA..



DHE NE DO TË
JETOJMË TË GJITHË
BASHKË.. NË PAQE!

URRA!

FAQJA E QARTËSISË

BARAZIA GJINORE ËSHTË NJË NGA PARIMET THEMELORE NË TË CILAT DUHET TË BAZOHET MARRËDHËNIA MES BURRIT DHE GRUAS. AJO LIND NGA DËSHIRA PËR BARAZI DHE MUNDËSI TË BARABARTA MES GJINIVE NË TË GJITHA FUSHAT E JETËS SHOQËRORE, KUNDËR ÇDO DISKRIMINIMI.

DALLIMET BIOLOGJIKE JANË ATO KARAKTERISTIKA FIZIKE DHE ANATOMIKE QË I BËJNË BURRAT DHE GRATË TË NDRYSHËM NGA NJERI-TJETRI... TË CILËT, SIDOQOFTË, JANË TË NJËJTË NË GJITHÇKA TJETËR! EDHE NËSE I PËRKASIN KOMUNITETEVE TË TJERA... PASI GJUHËT, KULTURAT DHE TRADITAT E NDRYSHME, DUKE U QASUR, VETËM MUND TË PASUROHEN NGA NJERA-TJETRA!

DISKRIMINIMI I USHTRUAR NDAJ KATEGORIVE TË NJERËZVE (PËR SHEMBULL, GRATË, EMIGRANTËT, ROMËT...) VJEN SI REZULTAT I NJË PROCESI QË, I NISUR NGA PARAGJYKIMET QË NUK PËRPUTHEN ME REALITETIN, ÇON NË PËRJASHTIMIN DHE SHKELJEN E TË DREJTAVE.

KUSHTETUTA ITALIANE ËSHTË BURIMI THEMELOR I TË DREJTËS NË TË CILËN BAZOHET REPUBLIKA JONË. PRANDAJ AJO ËSHTË LIGJI MË I LARTË I SHTETIT DHE PËRFAQËSON BAZËN E BASHKËJETESËS SONË CIVILE. NË TË JANË PËRCAKTUAR PARIMET DHE QËLLIMET QË SHTETI ÇAKTON VETË SI DHE NËPËRMJET SAJ RREGULLOHEN MARRËDHËNIET ME SHTETASIT DHE MES TYRE. NË TË JANË PËRFSHIRË TË DREJTAT DHE DETYRIMET TONA KRYESORE SI SHTETAS.

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE TË BASHKIMIT EVROPIAN SIKURSE EDHE KUSHTETUTA ITALIANE PËR TË CILËN SAPO KENI LEXUAR, U NJEH NJË SËRË TË DREJTASH PERSONALE, CIVILE, POLITIKE, EKONOMIKE DHE SOCIALE SHTETASVE DHE BANUESVE TË RREGULLT TË BASHKIMIT EVROPIAN.

NËSE QAN NUK KONSIDEROHESH SI VAJZË, NËSE TË PËLQEN TË LUASH FUTBOLL NUK KONSIDEROHESH SI DJALË. QARTË?

POR MBI TË GJITHA: NGJYRA E LËKURËS, E FLOKËVE DHE E SYVE JANË VETËM DISA DETAJE PËR TË CILAT NUK ËSHTË E DREJTË TË TALLENI ME NDOKËND!



JA DHE PROFESIONET E FAQES 13 NË GJININË FEMËRORE:
ARBITRE, ARKITEKTË, DREJTUESE, KIRURGE, KOMISARE,
KËSHILLTARE, DEPUTETE, INXHINIËRE, INSPEKTORE, NOTERE, PREFEKTE,
DREJTORE VENDORE E POLICISË, SENATORE, KRYETARE BASHKIE.



KEMI
ARRITUR
PIKËRISHT
NË FUND...

ISHTE KËNAQËSI TË
RRIJA ME TY...

SHIJO MIQËSINË
DHE QËNDRO NË
GRUP PA BËRË
DALLIME...

MIRUPAFSHIM E...
SHIHEMI HERËN TJETËR!
PUTHJEEE

KËSHILLA PËR LEXIM

NËSE TË PËLQEJNË HISTORITË E BUKURA TË KËSHILLOJMË TË LEXOSH:

"QIELLI NUK KA MURË" NGA AGUSTIN FERNANDEZ PAZ

"UNË JAM TI JE" NGA GIULSI QUARENHI

"PIPI CORAPEGJATA" NGA ASTRID LINDGREEN

PROTAGONISTËT DHE PROTAGONISTET DO TË TË ZBAVITIN PA MASË!



REGIONE
PUGLIA



MINISTERO del LAVORO
e delle POLITICHE SOCIALI

"Fondi për financimin e projekteve dhe aktiviteve me interes të përgjithshëm në Sektorin e Shërbimeve (nenet 72 e 73 të Dekretit Legjislativ nr. 117/2017) – Thirrje për pjesëmarrje në garë Puglia Capitale Sociale 3.0"

URRA!

REVISTA MBI BARAZINË GJINORE DHE KUNDËR LLOJEVE TË DISKRIMINIMIT.

Nga një ide e Antonio Stornaio, i cili është kujdesur, gjithashtu, edhe për tekstin në bashkëpunim me Annamaria Ferretti.

Realizimi: Shoqata Perbene Aps- Bari;

Shtypje dhe ngjitje: Stampa Sud, Mottola (TA)

Grafikë dhe ilustrime: Federica Cetola dhe Valentina Luso

Përkthyes: dok.sha Viljana Xhamija, Eva Meksi- Shoqata Shqiponjat e Mëndafsh-hta- Bari (Le Aquile di Seta- Bari)

Të gjitha të drejtat të rezervuara - Botim i ndaluar për shitje.